59	Berat	Isa Shmili	3,832,064	149	Lezhë	Manuel Nik Shabi		238	Berat	Gani Mekollari	1,123,986	327	Berat	Zeqir Abas Laze	3,015,600	
60	Lezhë	Kol Gjok Makaj	796,351	150	Lezhë	Prek Ivanaj	2,081,800	239	Lezhë	Shitjefen Vas Preçi	7,460,782	328	Berat	Kadri Cela	1,325,464	
61	Fier	Thoma Kusta		151	Lezhë	Martin Gjeka	3,305,898	240	Berat	Mehmet Kadri Shegani		329	Berat	Nazmi Xhaja	349,009	
62	Fier	Ahmet Haxhijaj, Eduart Haxhijaj, Hekuran Hodaj, Luftije Zeninaj (Hodaj), Nazif Haxhijaj, Rexhep Haxhijaj, Safete	611,398	152	Shkodër	Nazim Gremazi		286,184	241	Berat	Dhora Pjetri		330	Berat	Qazim Hoxha	2,706,816
63	Vlorë	Astrit Kallapodhi	49,800	153	Shkodër	Xhemalije Puka	2,200,140	242	Berat	DAFINA GALICA	739,520	331	Berat	Tomorr Jakllari	1,725,595	
64	Vlorë	Astrit Kallapodhi	1,845,543	154	Lezhë	Gjovalin Nikaj	12,970,650	243	Berat	Lili Thana	322,748	332	Berat	Qazim Buda	323,247	
65	Kukës	Shaqir Bilal Morina	102,268	155	Lezhë	Lek Turkaj		244	Berat	Sulejman Haxhillari	551,509	333	Berat	Levend Gjergjani	5,751,924	
66	Kukës	Ali Vocri Muca	1,012,638	156	Lezhë	Vitore Pjetrush		245	Berat	Xhafer Kamber Qamo	1,201,757	334	Berat	Maksim Kaci	766,094	
67	Kukës	Musa Halil Gojani	8,015,568	157	Lezhë	Ded Marku	2,891,135	246	Berat	Hajrulla Hysi	1,116,497	335	Berat	Muharrem Nonaj	1,186,800	
68	Berat	Selajdin Xhaferi	294,365	158	Shkodër	Pal Dodaj	-2,504,940	247	Berat	Hajrulla Hysi		336	Durrës	Shaban Jakova		
69	Berat	Selajdin Xhaferi		159	Lezhë	Ismail Bajram Hasani	2,107,000	248	Berat	Shpetim Pellumbi		337	Durrës	Sabri Kapexhiu	4,712,390	
70	Berat	Kamber Xhaferri		160	Lezhë	Gjek Tahiri	16,257,612	249	Berat	Majre Tajfur Kapedani (Shuka)		338	Durrës	Gëzim Tivari		
71	Berat	Kamber Xhaferri	4,790,080	161	Berat	Luftar Bega		1,234,004	250	Korçë	Ramadan Bregu	-12,384	339	Durrës	Areti Sema	4,744,150
72	Berat	Bektash Sherri		162	Berat	MALIQ BAZE		251	Shkodër	Bashksia Islamike Shqiptare		340	Fier	Filip Korraçe	3,321,024	
73	Berat	ZAIM SHERRI	422,350	163	Berat	MALIQ BAZE	2,050,681	Myftinjia Shkoder		31,065,150	341	Fier	Kujtim Pagria	15,445,608		
74	Berat	ZAIM SHERRI		164	Berat	Petref Jashar Shmili		252	Durrës		317,600	342	Korçë	Hamdi Hoxha	294,129	
75	Berat	Xhevdet Lavdari	223,974	165	Berat	Ali Hoxha	902,097	253	Vlorë	Barjam Tozaj	1,092,863	343	Fier	Marie Daka	1,349,166	
76	Berat	Xhevdet Lavdari		166	Berat	Ali Hoxha		254	Vlorë	Kostaq Basko	259,202	344	Fier	Abaz Libohova	11,655,905	
77	Berat	Hasan Lavdari	5,340,939	167	Berat	Selim Kelliçi	1,685,600	255	Vlorë		1,219,427	345	Fier	Areti Hasbra	3,829,556	
78	Berat	Idajet Hada	5,125,386	168	Berat	Qemal Zaimi	4,607,505	256	Vlorë	Jorgji Nushi	3,883,042	346	Fier	Sokrat Sema	5,355,151	
79	Durrës	Gëzim Shehu	2,415,248	169	Berat	Murat Dine Hajdari	6,573,840	257	Vlorë	Petrit Cobo		347	Fier	Qerim Krysi	3,005,355	
80	Fier	Todi Shkurti	-9,242,131	170	Berat	Dervish Qama	150,012	258	Vlorë	Selfo Rrapushi	4,664,500	348	Fier	Nushi Hrasnija	1,868,076	
81	Fier		-107,531,130	171	Berat	Baftjar Zylali	3,130,400	259	Vlorë	Ali Bestrova	1,329,089	349	Fier	Maliq Duraç	4,101,468	
82	Fier	Zija Vrioni		172	Shkodër	Engjell Ceka	644,140	260	Vlorë	Jazo Rama	1,395,702	350	Fier	Hodo Fejzulla	3,151,756	
83	Lezhë	Mark Ndoci	3,007,850	173	Korçë	Andrea Jakova	1,406,423	261	Vlorë	Guri Shyti	611,753	351	Fier	Adem Bogdani	1,006,493	

DEBATI

Ne të gjallët dhe muzeu te kampi i internimit, që e bën Tepelenën 'Aushvic'

Fatmira Nikolli

Në fillim të ndërtonim një tempull. Mos kemi bitisur me një kishë? Jo. Madje, nuk kemi bitisur asnjë nevojtoje. Përfundim me një kuzhinë plot myk, me një stufë të dorës së dytë. Ndezëm zjarrin në një kusi, ziemë, përziemë dhe traziam zjarr, gjak e çelik. Çfarë peshkuam në këtë çorbë të re? Njerëz të rinj? Njerëz prej graniti? Apo të paktën ndonjë përbindësh të llahtarshëm? Stepan Timoshenko i drejtohet shoku Morozov me një monolog ku zbrast të gjithë zhgënjimin e tij, pasi shihen qartë pasojat e revolucionit rus tek romani "Ne të gjallët" e Ayn Rand. Paralelet që mund të hiqen me Shqipërinë e pasluftës kur u dukën qartë pasojat e fitores komuniste, apo me çdo Shqipëri tjetër pasi qeverive u del boja e premtiveve të pambajtura nuk mund të anashkalohen. Por në turrarapin e krahasimeve me çaste historike, do na duhet shpesh të mbajmë hapat jo vetëm para veprave letrare. Për "Ne të gjallët", po aq rëndësi kanë edhe veprat inxhinierike apo godinat që bartin kujtesën për ata të vdekurit që nuk ia dolën t'i shpëtojnë. Qoftë edhe duke i vënë vetes e qyteteve tona damkën e turpit se ç'lejuan të ndodhë a ç'nuk mundëm të shmangim.

Kthimi në muze i ish-kampit të internimit të Tepelenës, një nisim e Autoritetit për Informim mbi Dosjet e Sigurimit të Shtetit në funksion të kujtesës për jetët e humbura, ka hasur së fundmi në një debat që po aq sa të shkuarën vë në pah edhe absurdin. Debatin nisi herët me etiketën e një krahasimi të çalë me Aushvicin (ne vramë më pak se nazistët), e kthehet së fundmi me një lutje për kreun e bashkisë që të mos e kthejë Tepelenën në Aushvic (për mes një muzeu). Po si mund ta bëjë Aushvic një muze nëse nuk që një vend torture e skamjeje? Pas debatëve në rrjetet sociale, thirrja për Termet Peçin (kreu i Bashkisë së Tepelenës) ka ardhur nga përtej Oqeanit. E reagimet kanë qenë të menjëhershme.

Pse fyhet Tepelena për atë që ka ndodhur në territorin e saj nga komunizmi; atë që në fakt ka ndodhur edhe në qytete e fshatra të tjera? Simon Mirakaj, një i mbijetuar i kampit që është pjesë e Autoritetit të Dosjeve, refuzon të shohë lidhje faji me banorëve dhe kampit të kahershëm. "Të

Simon Mirakaj: Nuk kanë faj mirditorët për Spaçin, as matjanët për burgun e Burrelit



nderuar zonja e zotërinj brenda dhe jashtë atdheut. Duke parë e dëguar disa zëra kundër bërjes muze të ish-kampit të Tepelenës me justifikimin se i prish imazhin Tepelenës (me këto zëra që u është bashkuar dhe një qytetar Ameri-

kan i quajtur Dioguardi), desha t'iu them këtyre zotërinjve se Tepelena nuk është e juaja, Tepelena është e juaja, është e imja, është e të gjithë atyre që flasin e mendojnë shqip, po kështu është dhe Gjirokastra, Shkodra, Tropo-

Ardian Ndreca: Kampi i shfarosjes ishte kamp i komunizmit dhe jo i popullit të Tepelenës

Enver Hoxha e shokët e tij. Ju zotëri me zërin kundër, gjykoni e arsyetoni me syrin e mendjes jo me atë të urrejtjes".

Po kaq i habitur nga qëndrimi është edhe Ardian Ndreca, profesor në Universitetin Urbaniana në Romë. "Joseph Dioguardi, një politikan pluri-dëshetak amerikan, nuk dihet se për çfarë alkimije u ba zadhanësi i disa komunistave të pacipë shqiptarë të cilëve u jep bezdi përkujtimi i viktimave të komunizmit shqiptar. Dioguardi me argumentet e tij qesharake u tregue një budalla i rrjedhur, lehtësisht i përdorshëm. Në vitin 1996 kur vinte në Tiranë për me mbështetë interesat e pakicës greke në Shqipëri ishte shumë ma i kthjellët se sot. Përkujtimin e viktimave të komunizmit sigurisht që s'do ta ndalin letrat e tij të neveritshme patetike, dhe as ata që

djallëzishit e kanë frymzue për me i shkruar. Kampi i shfarosjes ishte kamp i komunizmit dhe jo i popullit të Tepelenës. T'ia shpjegojë dikush këtë gjë këtij tevegeli të mërztshëm".

"Çfarë peshkuam në këtë çorbë të re? Njerëz të rinj? Jo. Kandrra të vogla e të shpifura që spërdridhen. Qenie të vogla që përkulen në të gjitha anët si të mos kishin kocka. Qenie të vogla që nuk ulin shpinën përulësisht për t'i fshikulluar me kamxhik, por marrin kamxhikun dhe fshikullojnë veten", vijon Stepan Timoshenko te "Ne të gjallët", duke përçar njëfarësoj detyrën që nëse jeta atyre të vdekurve shkoj, për hiçmosgjë, për një tekë a për një statistikë në kohën kur njeriut nuk i lejohej të mendohej, nëse me vdekjen e tyre na thanë ne se sa vlen jeta, më së paku, ne duhet t'i kujtojmë pa e quajtur varrin e tyre turpin tonë, jo se nuk është, po se nuk mundemi thjesht ta heqim sysh për të fshehur bëmën tonë, dëshimin tonë, krimin tonë.

KASTRIOT DERVISHI: DIOGUARDI, SI PATRIOT I FATURËS

"Diku në vitin 2002, një miku im, figurë shumë e njohur publike jopolitike udhëtoi në vendin e lirisë, në SHBA. Atje patriotët shqiptarë të shoqërisë më të njohur atje, i kishin përgatitur edhe një takim me z.Dioguardi. Siç më tregonte miku im kur u kthye nga vizita, takimi ishte 15 minuta. Në përfundim, Dioguardi, pasi pa i ngazëllyer tek ora e tij minutën e 15-të, i kërkoi të paguante faturën për kohën e takimit. Miku im nuk ishte në gjendje për të paguar, veprim që e kryen patriotët tanë të Amerikës, por këtë gjest nuk e kishte falur kurrë, madje ishte revoltuar. Kjo histori i vjetër mu kujtua teksa u bë publike letra me karakter komunal, politik dhe historik që kongresmeni amerikan në vitet 1985-1989 i dërgoi kryetarit të Bashkisë së Tepelenës, Termet Peçi, në të cilën shprehej i shqetësuar nga ndërtimi i një muzeu kombëtar në këtë qytet. Vëren se fjalët e përdorura nga z.Dioguardi, të tilla si "jam i shokuar", "thelësisht i shqetësuar", "plane të çuditshme", "një farë muzeu", etj., të krijonin përshtypjen se 78-vjeçari Dioguardi qenka fort i lidhur me një bashki të vogël si Tepelena dhe aspak me ngjarjet e tjera në Shqipëri. "Tezat që Dioguardi ka rreshtuar në letrën drejtuar z.Peçi janë të njëjta me ato të debatit të këtij viti me avokatët e krimit komunist, me të cilët kemi debatuar gjëra që janë tashmë publike. Argumentet që avokatët e komunizmit përdornin kundër nesh ishin: - Kampi identifikohet me krahinën e Tepelenës dhe lidhet me historinë e saj; Kushtet e jetesës nuk kanë qenë të këqija dhe ushqimi ka qenë i mirë (gati e quanin kamp pushimesh); Kampi nuk ka qenë më i keq se kampet e tjera, por duke e krahasuar me kampet e të burgosurve.

Ai shton se nëse Dioguardi do ta kishte seriozisht letrën e tij, mjaftonte të theksonte krimet e komunizmit, pa e lidhur këtë me krahasime nga koha e nazizmit, të cilat as unë nuk i kam qejf, sepse komunizmi shqiptar është krejt origjinal. Vë në dukje se të habit fakti se gjatë gjithë letrës së tij, z.Dioguardi nuk përmend fare fjalët "komunizëm", "të vuajturit nga komunizmi", "krimet e komunizmit", etj. Sikur të ishim skandinavë p.sh. nuk do kuptonim fare se për çfarë bëhet fjalë në letrën komunalo-politiko-historike.

Fibank Albania – Rezultate shume pozitive financiare për gjysmën e parë të vitit 2018

Gusht 2018

Fibank Albania vazhdon të shënojë rezultate mbresëlënëse sipas të dhënave të sistemit bankar për gjashtëmuorin e parë të vitit 2018

Rezultatet financiare të sistemit bankar shqiptar deri më 30 qershor 2018 treguan se Fibank Albania vazhdon ecurin e saj shume pozitive dhe renditet e para në treguesit e efektivitetit, Kthimit nga Aktivet dhe Kthimin mbi Kapitalin, (RoA & RoL).

Te dhenat tregojne se Fibank Albania shënojë 20% rritje neto te kredive ndaj biznesit dhe individëve dhe 10% rritje te totalit të aktiveve dhe depozitave ndaj klientëve, nder me te lartat ne sistemin bankar vendas. Gjithashtu është banka e vetme që po zgjeron rrjetin ne kete periudhe dhe këto arritje janë në vijim të treguesve të shkëlqyer financiarë të arritur në vitin 2017, qe eshte nje tregues i qarte i përkushtimit te fortë të Grupit Fibank në tregun shqiptar.

"Ne prisnim një vazhdim të zhvillimeve pozitive dhe punuam intensivisht për të arritur këto rezultate - thote Drejtori Ekzekutiv i Fibank, z. Bozhidar Todorov - Ne synojmë që viti 2018 të jetë edhe më mirë se 2017, viti ynë më i mirë deri më tani, dhe kjo është e bazuar në përpjekjet tona të përditshme në të gjitha drejtimet e mundshme".

Çdo klient potencial do të gjejë tek skuadra e përkushtuar e Fibank dedikimin për të krijuar një bashkëpunim të frytshëm dhe avantazhe reciproke për një marrëdhënie afatgjatë.

E DIEL

19 Gusht

2018



DOSSIER

Ismail Qemali është jo thjesht figura themelore e pavarësisë shqiptare, por edhe një nga ideatorët për ndryshime strukturore në qeverinë osmane. Jo më kot, figura e tij ka merituar shkrime dhe përmendje nga më të ndryshmet. Kurse një shikim ndryshe i tij na jepet në një roman historik, "Sulltani i fundit" i autorit Mishel de Gres, botuar kohë më parë nga "Plejad", ku tregohet ngjitja e tij deri në postet më të larta të Perandorisë Osmane. Kuptohet se romani është fikshën dhe një moment e përshkruan Ismail Qemalin, deri në postin e kryetarit të Parlamentit, post që ai nuk e ka pasur realisht, por tregon në të vërtetë, pozicionin e tij tepër të rëndësishëm në Perandorinë osmane. Në këtë shkrim do të përshkruajmë idenë e tij për një Konfederatë, e cila duket pak a shumë, si Bashkimi Evropian i ditëve tona. Kuptohet se Perandoria autarkike, megjithëse i kërkonte direkt fjalët e tij - nuk i donte këshillat e Ismail Qemalit, madje tentoi që ta eliminonte dhe kështu - në fund të jetës së tij - ai u morr me ëndërrën dhe me atë që e bëri të pavdekshëm: Pavarësinë e Shqipërisë

...
Eshhtë e tepërt që të merresh me jetëshkrimin e thjeshtë të burrë-shtetit të madh Ismail Qemali. Jo se kjo nuk ia vlen, por për një arsye tjetër, figura e tij ka qenë e madhe në aspirata, që sot popujt evropianë i ëndërojnë: Në krijimin e një bashkësie shtetesh të pavarur. Në këtë roman historik del dhe roli i tij i madh për forcimin e shtetit osman, që jeton në grahamat e tij dhe figura e tij poliedrike.

"Ismail Qemali ishte kundër faktit që një vend sado i vogël të mbetej i izoluar brenda kufijve, pa lëvizje tregtare e pa marrëdhënie me vendet e tjera. Por marrëdhëniet ekonomike nuk duhet t'i detyronin atij vendi heqjen dorë nga pavarësia politike, por me një ekuilibër të aftë, duhet t'i siguronin gjallërinë", shkruan Vjollca Tafaj, e cila është marrë me përgatitjen e kujtimeve të Ismail Qemalit.

→ Vizion në faqen 14



Kur Ismail QEMALI

u propozoi osmanëve të bënin një "Konfederatë Evropiane"



A

ARGUMENT

Ky qëndrim i burrit të Pavarësisë lidhet me kohën kur ai ende mendonte për autonominë “në suazën e Perandorisë”. Dhe, nga kjo kohë, është edhe propozimi që i bëri Sulltanit, për të penguar Rusinë, që donte të dilte me anë të Kostadinopolit në Mesdhe më 1892. “Një politikë e dobishme për të tashmen e për të ardhmen do të ishte prirja drejt vendosjes së një pakti midis shteteve ballkanike përmes arritjes së një aleance mbrojtëse dhe një marrëveshje ekonomike, prelude të kushtetutës së një shteti të madh Oriental” -... i shkruan shqiptari i madh sultanit...

Ismail Qemali dhe ideja e tij për një konfederatë popujsh

NGA BEN ANDONI

Vijon nga faqja 13

Duhet pranuar se Shkëlqesia e tij Ismail Qemali, për shkak të pozicionit dhe kontributit që kishin dhënë shumë njerëz të tij për Historinë e Turqisë, ishte për një demokratizim të Perandorisë. Ai kërkonte që të hiqej centralizmi absolut, sepse kjo amalgamë popujsh, e cila ishte në sundimin osman- nuk mund të rregullohej në kohët moderne me një dorë të vetme. Dhe, arsyeja e tij nuk mund të kundërshtohet. Ai, vetë, kishte lëvizur në poste të ndryshme në hapësirat e Perandorisë dhe kishte parë me sytë e tij- ndryshimet thelbësore që ishin në zakonet e popujve të ndryshëm në kulturë, besim, zakon, por edhe në mjediset krejt të ndryshme gjeografike ku jetonin. Si një njohës i mirë i historisë së Evropës- ai kishte idenë e një Konfederate të madhe, që afroonte pak me konceptin helvetik, ku rregullimi i çdo vendi në mënyrë autonome do të ndikonte në rregullimin e përgjithshëm. Ky vizionar, po të zhvendosesh pak në kohë dhe në hapësirë mund ta kuptosh lehtë, sesa mund të kuptohej nga bashkëkohësit, që i kishin sytë akoma të lbyrur me shekujt e lavdisë osmane?! Përmes situatave të ndryshme- në romanin e fundit historik- del edhe roli i plotë dhe shumë i veçantë i këtij burkroati “të frikshëm” të Perandorisë. Të cilin e adhuronin dhe poaq e luftonin. “Mendja e tij e mprehtë dhe idetë novatore bënë që sultanin Abdyl Hamiti të kishte njëherësh respekt e frikë prej tij. Ndonëse e internuan për disa vjet, atij nuk reshtën së dhëni grada”, saktëson për të Edwin Jacques tek “Shqiptarët”.

Ishte koha, kur ai ishte për autonominë “në suazën e Perandorisë”. Dhe, nga kjo kohë, është edhe propozimi që i bëri Sulltanit, për të penguar Rusinë, që donte të dilte me anë të Kostadinopolit në Mesdhe më 1892. “Një politikë e dobishme për të tashmen e për të ardhmen- do të ishte prirja drejt vendosjes së një pakti midis shteteve ballkanike përmes arritjes së një aleance mbrojtëse dhe një marrëveshje ekonomike, prelude të kushtetutës së një shteti të madh Oriental” -... i shkruan shqiptari i madh-Sulltanit.

Nga shqyrtimi i dokumenteve del se deri në vitin 1908, në kokën e tij, ishte e ideuar mirë që pavarësia ekonomike, ose një mundësi ekonomike më e madhe- do të ishte ajo që do të ndihmonte për një pavarësi. Historianët vërejnë, se ky ishte një koncept i avancuar, sepse në atë kohë- vendet e ndryshme, peshën e tyre e matnin me fuqinë



politiko-ushtarake.

“Vendosja e bashkëpunimit të lirë, që propozoj unë, do t’u jepte popujve të çdo shteti të drejtën që

të vendosen në çdo pjesë të Perandorisë së madhe dhe të kenë përkatesinë e saj, me lirinë për t’u futur çdo ndërmarryje që dëshirojnë.

Kush dhe si ishte Ismail Bej Qemali

Nga romani i fundit, “Sulltani i fundit” i Mishel de Gres- mund të gjykohej për një burkroat modern të Perandorisë dhe një burrë trim, që ka kapur të gjithë atë që mund të kapte një njeri i rangut të tij në Perandori. Bashkëkohësit e kujtojnë të tillë: “Ismail Beu ishte me trup pak më të lartë se mesatarja dhe i fuqishëm. Një fytyrë plaku simpatik, me mjekër e flokë të bardhë, që i jepnin autoritet e respekt. Kishte tippare të rregullta, sy të çelët dhe biseda e tij ishte e kënaqshme dhe e ëmbël. Kur zemërohej- ndërpriste fjalën, pa e ngritur kurrë zërin. Nuk fliste kurrë keq për asnjë. Të gjithë ata që e njihnin dhe kishin rast të bisedonin me të, pa përjashtim kishin përshtypjen për një burrë të mirë dhe me shpirt të lartë e të urtë. Ishte i pajisur me një inteligjencë dhe kulturë tepër të gjerë. Ishte tepër krenar për vendin e tij. Nuk tregonte asnjë interes për pasurinë dhe nuk u jepte rëndësi parave... Ishte shpirtmadh e shumë i sjellshëm, si edhe thellësisht demokrat në sjelljen e tij”... kujton një nga personazhet që e ka njohur dhe që është cituar në Historinë e tij.

I ati, Mahmuti, ishte një nga krerët e një kryengritje kundër Turqisë. Por, pas humbjes së kryengritjes, ai përfundoi i internuar në Konia të Anadollit. Edhe familja e tij u largua nga Vlorë dhe iu desh të qëndrojnë disa vite e mërguar në Selanik. Atje shkoi dhe djali i vogël pesëvjeçar i Mahmutit, Ismail Qemali, që kishte lindur më 24 janar 1844. Në këtë vend, ai mori dhe arsimimin e tij. Mësoi shumë mirë turqishten dhe greqishten, por njëjtë veç kësaj shumë mirë dhe italishten e frëngjishten. Pasi mbaroi dhe “Zosimean” shkoi në Stamboll, ku studioi për Jurisprudencë dhe njëkohësisht punonte në Ministrinë e Jashtme si përkthyes. Kujtohet se këtu pati një ndih-

Turqia do të kishte avantazhin e rivendosjes së unitetit të saj, si shtet në kufijtë e vjetër, por, në vend që t’ia kushtonte energjitë ndalimit të emancipimit të njerëzve... fuqia e saj do të qëndronte në unitetin e njerëzve për mbrojtjen e përbashkët, kurse energjitë e tyre do t’i kushtoheshin zhvillimit ekonomik të perandorisë”. Një mësim brilant nga historia e tij për kujtimin e Perandorisë Osmane. Krahas me këto, Ismail Qemali, kishte filluar të mendonte ndryshe për vendin nga vinte origjina e tij. Kështu, në programin, që i paraqiti ambasadorit italian në Londër, një mikut dhe adhuruesit të tij, Antonio di San Xhuliano ishte: “Qëllimi i vendosur për të luftuar: që në gjithë vendet, që flitej shqip, t’i përkisnin Shqipërisë; përhapjen e shkollave shqipe me alfabetin latin; një hekurudhë Vlorë-Manastir; në mënyrë që të kishte akses në Selanik, një nga portet më të

mëdha të Mesdheut, hyrjen e kapitalit të huaj”. I gjithë ky mozaik do t’i jepte vendit më shumë fuqi administrative...

Si një burkroat i vjetër i perandorisë, ai nuk mund të shtynte dot dhe rënien e përnjëhertë të Perandorisë, ndaj në mendimet që i kërkuan, ai i kërkoi direkt Sulltanit, që të shpallte Kushtetutën e re, që në fakt ndodhi. Për këtë kushtetutë kishte vdekur dhe Mit’hat Pasha, mësuesi i tij, që përmendet aq shumë në romanin historik dhe ku tregohet njëherazi dhe figura e këtyre dy personazheve për zhvillimin e Turqisë.

Por, nuk kishte kohë më për të. Tashmë, protagonistë të Turqisë janë bërë Turqit e rinj, ose xhonturqit, të cilët synonin dhe iu drejtuan menjëherë pushtetit absolut. Më 15 shkurt 1909, Komiteti i “Bashkim-Përpërimit” iu sul personazheve të njohur një prej të cilëve ishte dhe Ismail Qemali, i saporehabilituar nga internimi i radhës. Ai u qëllua në Parlament dhe gjithë Turqia e tij prej fundimitarë ndaj Turqisë duke kërkuar tashmë në mënyrë finale rrugën e Shqipërisë. Kishte marrë fund edhe ëndrra e tij e madhe, për të krijuar një konfederatë moderne, që të përbehej nga disa vende, të cilat do të ishin të pavarura...

Ajo që ndodhi pastaj me jetën e njeriut vizionar- dihet dhe është përsëritur shpesh. Më 5 nëntor 1912- në Rumani u bë një mbledhje e madhe e shqiptarëve, por nuk dihej nëse do të shpallej autonomia apo Pavarësi. Ismail Qemali e kishte busullën e tij dhe mendonte se për çështjen shqiptare në atë kohë nevojitej vetëm diplomacia e madhe. Nga këtej, ai shkoi në Budapest, ku u takua me ministrin Bertold dhe pastaj iku në Vienë. Kishte gjetur mbështetjen e vërtetë, e cila ishte nga Italia dhe Austria- dhe epilogu i kësaj përpjekjeje ishte në Trieste, kur ai shpallli në momentin e nisjes me anijen “Bryn” - vendimin e madh për të shpallur Shqipërinë të pavarur. Sipas parashikimit, nuk mundi ta bënte këtë në Durrës- për shkak të ushtrisë serbe që po i afrohej qytetit. Ndaj, iku në Vlorë- ku shpalli në të njëjtën ditë me Skënderbeun më 28 nëntor 1443, Pavarësinë... Kishte lindur kështu dhe shteti më “i ri” i Ballkanit, që ishte ngjizur që me kohën e Zotërve Paganë. Epilogu zyrtar ishte më 1 Dhjetor 1912, kur “Autonomia Shqiptare” u njoh edhe nga Fuqitë e Mëdha, por kuptohet jo nga Greqia dhe Serbia...

Ben Andoni

Sulltani i fundit

NGA MISHEL DE GRES*

Nuk kishim mbaruar ende së ngrëni, kur shoqëruesi, që kishte radhën e shërbimit, më njoftoi se lidhjet telefonike e telegrafike ishin vendosur. Thirrja e parë vinte nga Ismail bej Qemali. Atij i ishte dashur të pushtonte Centralin Telefonik të Parlamentit, sepse ndërtesa ndodhej në duart e ushtrisë. Jashtë ndërtesës ndodheshin rreth njëzet e pesë mijë ushtarë, kurse hollit dhe galeritë e Dhomës së deputetëve ishin plot me njerëz të armatosur e ku nuk bëhej asnjë oficer i gjallë. Ministriat, përfaqësuesit e Komitetit "Bashkim e Përparim" dhe Ahmet Rizai, presidenti i Parlamentit, ia kishin mbathur të parët. Nuk kishin të më qeveri, nuk kishte më Parlament, hierarkia ushtarake nuk ekzistonte. Ismail Qemali u kërkoi ushtarëve të dilnin nga salla, por ata nuk pranuan. Një ulemë, në moshë të re, hipi në tribunë dhe mbajti një fjalim të fortë kundër shoqërisë "Bashkim e Përparim". Në atë konfuzion të jashtëzakonshëm, e pasuan shumë deputetë.

Debatit vazhonte i zjarrtë dhe ushtarët ishin të nervozuar. Më në fund, u vendos që një përfaqësi të vinte në Ildiz, të më kërkonte të rrezjoja qeverinë e të amnistioja rebelët.

Përfaqësinë e kryesonte Ismail

Qemali, por, kur mbërritën pranë Portës së Lartë, një kordon i ngjeshur ushtarësh e ndaloi. Urdhëri ishte të mos lejohej absolutisht

askush të kalonte, prandaj tytat e pushkëve u drejtuan nga karrocet e dërgatës. Ismail Qemali zbriti nga karroca e tij dhe u përpoq të

bisedonte, por pa rezultat. Përfaqësia u kthye në drejtim të Parlamentit, ndërkohë që, një breshëri e vazhdueshme të shtënash, krijoi një panik të përgjithshëm.

Duke mos patur mundësi të më takonte në Ildiz, Ismail Qemali m'u lut në telefon të emëroja një tjetër vezir të madh. Shkarkimi nga detyra i funksionarëve, i njerëzve, që deri atëherë kishin qenë në pushtet, imponohej nga nevoja e zgjidhjes urgjente të situatës, për të shmangur anarkinë dhe për të frenuar veprimet e ushtrisë, që ulërinte në sheshin At Meidan.

Megjithatë, emërimi i një tjetër veziri të madh do të më kompromentonte me kryengritjen, pikërisht në çastin, kur unë dyshoja në natyrshmërinë e saj. Më vinte neveri të dilja garant, duke mos patur të bëja fare me ata. Megjithatë, të gjithë më konsideronin autorin e atij reaksioni konservator të drejtuar kundër shoqërisë "Bashkim e Përparim".

Isha shtrirë, mbi shezlong, duke diskutuar me veten time, për vendimin që duhej të merrja kur, në orën katër të pasdites, Ismail Qemali, më mori në telefon nga Parlamenti, ku ndodhej ende. Ai më përshkoi pamjen e sheshit At Meidan, që e vërente nga dritarja. Ushtarët, vazhdimisht të shumtë



Memorandumi drejtuar Sulltanit nga Shkëlqesia e tij

I paraqitur Lart Madhërisë Perandorake Sulltanit Abdyl-Hamid nga Ismail Bej Vlora, ish guvernator përgjithshëm i Tripolit

Lart Madhëria Juaj Perandorake mban mënd se me kthimin tim nga Bejruti, i paraqita Lart-Madhërisë Suaj një memorial të gjatë, me të cilin i shpjegoja qartë, se politika e ndjekur në marrëdhëniet me Fuqitë e Huaja e në administrimin e brendshëm të vendit, po e çonte Perandorinë drejt një rreziku të madh...

Në atë dokument, vija në dukje që mënyra veprimi të padenja për një perandori të madhe, ashtu si edhe qëndrimin indiferent i Fuqive të Mëdha, gjë që nga ana e oborrtarëve lajkatarë i paraqitej Lart Madhërisë Suaj si një sukses i madh politik, përbente një gjendje izolimi të plotë për perandorinë, që ishte e barazvlefshme me vetëvrasje. Vija gjithashtu në dukje mënyrën më të qartë, se administrimi i keq i ushtruar në Provinca, sillte uljen e autoritetit të fronit e shkatërrim për shtetasit e Lart Madhërisë Tuaj të çdo klase. Vija gjithashtu në dukje në mënyrën më të qartë, se administrimi i keq i ushtruar në provinca, sillte uljen e autoritetit të Fronit e shkatërrim për shtetasit e Lart Madhërisë Suaj të çdo klase.

...Padyshim, Madhëria Juaj e kupton tashti se këmbëngulja e forca ime, që arritën kufirin me guximin për të paraqitur aspektet e situatës, siç ishte në të vërtetë, nuk ishte tjetër veç efekti i dëshirës sime të sinqertë, për të gjetur mjetet për të siguruar shpëtimin e Lartmadhërisë Suaj e të Perandorisë. Jam i sigurt se Lart Madhëria Juaj është thellësisht i bindur, se nëse këto reforma, nevoja e të cilave tashti është e dukshme, do të ishin realizuar në atë kohë me besim e sinqeritet, Perandoria nuk do të ishte kërcënuar dhe provincat nuk do të kishin qenë shesh i masakrave dhe plaçkitjeve. I lutem Madhërisë Suaj, të besojë se ky studim për ngjarjet e viteve të kaluara e kjo përsëritje e rekomandimeve të mia personale, nuk kanë aspak qëllim që të vendosen në pozicion polemike me Lart Madhërinë Tuaj. Unë jam i sigurt që me ciltërsinë e Zotit të kësaj toke, të Sovranit të Perandorisë e të Babait të gjithë osmanëve, Madhëria juaj nuk ushqen aspiratë tjetër veç kënaqësisë së zhvillimit të shtetasve të tij dhe lumturi e lavdi për perandorinë e tij... Dekretet, ligjet dhe rregulloret e shpallura gjatë njëzet viteve të mbretërimit të Madhërisë Suaj, sikur të grumbulloheshin me qëllim përfitimi, do të formonin një kod të plotë, që përmbushte formulat më të mira të një qeverisjeje të mirë e zgjedhjet për të gjitha problemet administrative e gjyqësore. Fatkeqësisht, këto norma, janë ngatërruar me të tilla kushte e sigurime, e zbatimi i tyre iu besua funksionarëve aq të plogët e të paaftë, saqë qëlli-

met e mira të Lart Madhërisë Suaj kanë mbetur shterpë dhe vendi nuk ka patur asnjë përfitim...

Kur pasardhësit e trashëgimtarët e Lart Madhërisë Suaj do të krahasojnë rezultatet e përgjithshme të arritura deri më sot, kaq në kundërshtim me premtimet e shkëlqyera të fillimit të mbretërimit dhe kur do të përpigjen të zbulojnë shkaqet misterioze të katastrofave, që kanë tronditur qeverinë e popullin, në këto 20 vjet, do ta kenë me të vërtetë të vështirë të shpjegojnë këtë kundërshtie dhe nuk do të dinë të mallkojnë sa duhet ata që kanë qenë shkaku i ndryshimit që u sollti kaq fatkeqësi atyre dhe interesave të tyre. Është fjala për ata, që duke shpifur për të tjerët, u përpoqën për të tërhequr vëmendjen tuaj, që e konsiderojnë meritë të spiunojnë njëri-tjetrin, e që e kanë bërë tregtimin e informatave një mjeshtëri aq të zakonshme, saqë babai kallëzon djalin e vëllezërit akuzojnë njëri-tjetrin. Në sajë të tyre, korrupsioni është përhapur aq shumë në çdo nivel, saqë administrata qendrore dhe qeverisja lokale kanë mbetur në dorë të njerëzve krejtësisht të padenjë për të vepruar si përfaqësues të Madhërisë Suaj. Për shkak të tyre, vendi tash, ndodhet pa administratë përgjithësisht të ndershme, pa garanci të qeverisjes së mirë. Ushtarët, që janë mbrojtësit e vendit, kanë humbur çdo disiplinë. Marina, pastaj gjithashtu është bërë shesh shfrytëzimi për interesa vetjake, ndërsa financat e shtetit jo vetëm janë shkatërruar, por çrregullimet në drejtim të tyre shkaktojnë çdo imajinatë...

Sovran! Zotëria im! Ti që je në dijeni dhe të grindjes më të vogël midis burrit e gruas në familjen më të thjeshtë të vendit, duket se nuk i njeher rreziqet, që sot kërcënojnë të ardhmen e Fronit dhe ekzistencën e vetë Perandorisë...

Duke mbyllur vërejtjet e mia, kam nderin t'i propozoj Madhërisë Suaj të pëllirë menjëherë një Asamble Kushtetuese të përfaqësuesve të popullit e kryeqytetit e të gjithë provincave. Kjo Asamble do t'i parashtrijë Madhërisë Suaj ndryshime, që do t'i quaj thelbësore për t'i bërë kushtetuese, kur këto variante do të adoptohen. Karta e re mund të marrë aprovimin tuaj e të shpallet me një Hatt të veçantë. Unë jam i bindur se kjo është e vetmja mënyrë për të riparuar të këqijet e momentit aktual. Dhe, jam i sigurt që Madhëria Juaj, kur kjo Kushtetutë e rishikuar do të shpallet, do të kërkojë garancinë e Fuqive të Mëdha, ashtu si babai juaj i ndritur kërkoi në kohën e Tanzimatit, ato do të njohin vlerën e regjimit të ri dhe do të detyrohen ta respektojnë gjithnjë, në mënyrë që të drejtat sovraane të Madhërisë Tuaj, si edhe tërësia tokësore e pavarësia e perandorisë Osmane, do të jenë të pranuarra e të sigurta...

(Shkëputur nga letra e Ismail Qemalit, drejtuar Sulltanit)

në shesh ulërinin gjithmonë e më shumë.

- Vdekje Komitetit! Vdekje Bashkim Përparimit!

Thirrjet dhe zhurmat ishin aq të forta sa, nëpërmjet telefonit, edhe unë dëgjoja një zallama shurdhuese shpërthimesh, trompetash e daullesh. Në atë përzjerje të paformë, arrija të dalloja thirrje në përkrahje të Sheriatit, e sidomos atë, që ia kisha frikën:

- Rroftë Padishahu!

Me zë të ndërprerë, Ismail bej Qemali m'u lut edhe njëherë të vendosja një tjetër vezir të madh. Nuk duhej humbur asnjë minutë. Ishim në prag të kaosit e të gjakderdhjes.

Fantazma e luftës civile vinte rrotull. Mendimi im u përqendrua mbi Tefik Pashën, i cili, për një periudhë të gjatë kishte qenë funksionar në ministrinë e Punëve të Jashtme dhe i njohur për ndershmëri. I ofrova qeverinë, nëpërmjet telefonit. Ai pranoi. Po nëpërmjet telefonit, ia bëra të ditur vendimin tim dhe Ismail Qemalit. Duke e dëgjuar, kapa një psherëtimë lehtësimi, që doli nga goja e tij. Ai më falënderoi për vendimin, që u mor në çastin e duhur, sepse ushtarët po ndizeshin gjithnjë e më shumë.

I dërgova Parlamentit një telegram zyrtar, ku konfirmoja emërimin e vezirit të madh dhe një amnisti për rebelët. Për të qenë brenda rregullave, i dërgova menjëherë Xhevat Pashën me Hati Herifin, ku tregojhej formimi i qeverinës së re.

Xhevati arriti t'i kapërcejë rreshtat. Sapo mbërriti ai, Dhoma u mbloodh. Gjashtëdhjetë deputetëve të mëngjesit, iu shtuan edhe dhjetë të tjerë. Ata zgjidhën president, me vota të plota, Ismail Qemalin, i cili m'u lut që të emëroja sa më shpejt një ministër të Luftës. Aty për aty, mendova për Et'hem Pashën, njeriun e situatave të vështira, shumë popullor për trupat.

Në kohën, kur do të njoftoja Ismail Qemalin për zgjedhjen, që kisha bërë, linjat u ndërpre në përsëri. Nisa një shambellan në shtëpinë e Et'hem Pashës për t'i thënë të shkonte sa më shpejt në Parlament, që të ndihmonte ligjëshmërinë. Me Ismail bej Qemalin kontaktova vetëm afër mesnatës. Ushtarët kishin nisur të lëviznin nga vendi, kur u përhap fjala se topa dhe mitralozja ishin drejtuar nga Ministria e Luftës, mbi ata.

Gjatë këtyre zhvillimeve, ministriat e vjetër të Marinës e Drejtësisë të qeverisë së dorëhequr, ishin sulmuar në sheshin At Meidan nga ushtarët, që ishin tërbuar sa kishin parë ata dy përfaqësues të regjimit të urryer. Kur pa se karroca e tyre ishte rrethuar, ministri i Marinës nxori revolverin dhe shtiu mbi ata, që i sulmuan. Një breshëri e gjatë, që i la të vrarë në vend, bashkë me kolegim, iu përgjigj. Kryengritësit, të përfshirë në një valë tërbimi, që ua kishte shtuar era e gjakut, ia sollën të dy kufomat, Ismail bej Qemalit. Ardha, në kohën e duhur, e Et'hem Pashës u prit me entuziazëm të sinqertë. Ministri i ri, duke mposhtur shqetësimin dhe mërzinë, u bëri thirrje ushtarëve të ktheheshin në kazerma. Prania, forca e tij, por patjetër, edhe lodhja, që kishte filluar të rëndonte mbi njerëzit, bënë që t'i bindte. Të shtënat në ajër, që bëheshin për të shprehur pëllqimin e tyre, tronditën Konstandinopojën e vjetër e u dëgjuan deri në Ildiz.

*Kjo është një pjesë e shkëputur nga romani historik "Sulltani i fundit"

P

POEZIA

Përkthyesja na sjell një autore irakiane, e cila tashmë jeton në SHBA. Trishtimi, që rrjedh nga poezia e saj dhe historia e tmerrshme e këtij vendi, bën bashkë trashëgiminë e një kulture të madhe, por edhe fatalitetin e kohës, që e dërrmoi këtë vend. Me shprehjet e kursyera ndërlidhur me një figuracion shumë interesant vjen një copëz e madhe e inkoshiencës së këtij vendi. Përkthyesja Mirela Petalli (Kapaj) duket se ka punuar shumë këndshëm...por mbi të gjitha duhet vlerësuar se ka marrë edhe copyright për botimin



CILA ËSHTË DUNYA MIKHAIL

Dunya Mikhail është një poete Irako-Amerikane lindur në Bagdad. Pasi mbaroi studimet universitare ajo punoi si përkthyes dhe gazetare për Baghdad Observer para se ta përfshinin në listën e armiqve të Sadam Hyseinit. Mikhail emigroi në Shtetet e Bashkuara të Amerikës në mesvitet 90 dhe përfundoi studimet master në Universitetin e Wayne State. Autorja ka botuar disa libra me poezi në gjuhën arabe. Libri i parë i botuar në anglisht, "The war works hard" (2005) përkthyer nga Elizabeth Winslow, fitoi çmimin PEN për përkthimin, ishte në listën e shkurtyr të çmimit Griffin për poezi dhe u zgjodh si një nga 25 librat më të mirë të vitit 2005 nga Biblioteka publike e New York-ut. Ndërsa libri "Diary of a wave outside the sea" (2009), të cilin autorja e përktheu në bashkëpunim me Elizabeth Winslow, fitoi çmimin e librit Arabo- Amerikan. Autorja është nderuar nga Kombet e Bashkuara me çmimin e të drejtave të njeriut për lirinë e të shkruarit.

NGA DUNYA MIKHAIL*

Pllaka I

1
Ajo ngjeshi guackën në vesh:
Donte të dëgjonte gjithçka
Që ai nuk ia tha kurrë.

2
Një inç i vetëm
Ndan dy trupat e tyre
Përballë njëri-tjetrit
Në foto:
Një buzëqeshje në kornizë
Varrosur nën rrënoja.

3
Sa herë që ti hedh gurë
Në det
Çon rrrathë mepërmas meje.

4
Zemra ime është fare e vogël:
Ndaj mbushet kaq shpejt.

5
Uji s'ka nevojë për luftëra
Të përzihet me ujë
E të mbushë hapësira.

6
Pema nuk hamendëson pse nuk
shpërngulet
Në një pyll tjetër
E as nuk bën pyetje të tjera të kota.

7
Ai sheh televizor
Teksa ajo mban në dorë një roman.
Në kopertinën e romanit
është një burrë që po sheh televi-
zor
Dhe një grua që mban në dorë një
roman.

8
Në mëngjesin e parë
Të vitit të ri
Të gjithë ne do ngremë sytë lart
Drejt të njëjtit diell.

9
Ajo ia ngriti kokën mbi gjoksin e
saj.
Ai nuk u përgjigj:
Ai kishte vdekur.

10

Personi që më vështroi kaq gjatë,
Dhe që vështrimin ia ktheva kaq
gjatë...
Ai burrë që kurrë s'më përqafoi,
E që s'e përqafova kurrë...
Shiu përmbysi ngjyrat rreth tij
Në atë telajo të vjetër.

11
Ai nuk qe mes burrave
Që kishin humbur e i gjetën:
Nuk erdhi me të burgosurit e
luftës,
As me balonën që e çoi atë,
Në ëndrën e saj,
Drejt një tjetër vendi,
Teksa ajo qëndroi para aparatit
Që t'ia ngjisinin buzëqeshjen në
pashaportë.

12
Hurmat janë bërë pìrg
Buzë rrugës:
Mënyra jote
Për të më puthur.

13
Flokët e Rapunzeit
Që prekin tokën
Prej ditrares
është mënyra jonë e pritjes.

14
Hijet
Që lanë të burgosurit
Në mur
E mbështollën rojen
Dhe lëshuan dritë
Mbi vetminë e tij.

15
Atdhe, unë nuk jam nëna jote,
At'herë pse qan kështu në prehrin
tim
Sa herë
Që të dhemb diçka?

16
Mos u mërzit prej këtij zogu:
Vjen çdo ditë
Dhe ndalet në cep të degës
E këndon për një orë
A dy.
Vetëm këtë bën:
Asgjë tjetër nuk e lumturon më
shumë.

17
Çelësa shtëpie,
Karta identiteti,
Foto të zbehura mes eshtrave...
Të gjitha këto shpërndarë
Në një varr të vetëm masiv.

18
Gjuha arabe
I pëlqen fjalitë e gjata
Dhe luftërat e gjata.
I pëlqen këngët që s'mbarojnë
Netët e vona
Dhe vajtimin mbi rrënoja.
Pëlqen të punojë
Për një jetë të gjatë
Dhe një vdekje të gjatë.

19
Shumë larg prej shtëpisë—
Vetëm kjo ndryshoi tek ne.

20
Hirushja e la sandalen e saj në Irak
Bashkë me aromën e kardamomit
Që përhapet prej çajnikut,
Dhe atë lule të stërmadhe,
Me gojë të shqyer si vdekja.

21
Mesazhet e shpejta
Ndezën revolucione.
Flasin jetë të reja
Duke pritur për një vend ku të sh-
karkohen,
Një tokë që është pak më shumë
Se një grusht pluhur
Kur përballet me fjalët:
"Asnjë rezultat nuk përputhet me
kërkimin tuaj."

22
Eksitimi i qenit
Teksa i sjell shkopin të zotit
është momenti i hapjes së letrës.

23
Ne i kalojmë kufijtë lehtas
Si re.
Asgjë nuk na mbart,
Por teksa lëvizim tutje
Ne mbartim shi,
Dhe një theks,
Dhe një kujtim
Të një vendi tjetër.

24
Sa emocionuese të shfaqesh në sytë
e tij.
Ajo nuk kupton çfarë thotë ai:
Ajo është e zënë duke përtypur
zërin e tij.
Ajo sheh gojën që s'do ta puthë
kurrë,
Supin ku nuk do qajë kurrë,
Dorën që s'do e mbajë kurrë,
Dhe tokën ku hijet e tyre takohen.

Pllaka II

1
Mbyll sytë dhe shoh një pikë.
Bëhet një njollë drite.
Rritet sa një njeri
Që largohet tutje
Derisa kthehet në një njollë drite,
Një pikë.

2
Si buka e meshës
Fjalët e tua treten në gojën time
Dhe nuk vdesin kurrë.

3
Nuk dua t'ia di nën cilin qiell—
Veç këndoje këngën tënde deri në
fund.

4
Qyteti-kockë që më ka ngecur në
fyt
është edhe kripë

Edhe sheqer
Edhe ujë që vlon
në çajnikun pa kapak.

5
Mos pyet sa shtëpi u ndërtauan.
Pyet sa banorë mbetën në ato sh-
tëpi.

6
Flaka hapet si një bimë gjigande
E i gëlltit një e nga një
Me delet e tyre të gjetura e të hum-
bura.

7
Ajo kënga e së cilës
Nuk ka as fillim
E as fund—
Ajo zëri i së cilës u venit
Nëpër yje e hëna—
Ku është ajo?



...nga numri i shkuar

"Milosao" e këtij numri ishte relativisht e mirë. Shkrimi kryesor ju la një letër të hartuar nga dy njerëz të shoqërisë civile amerikane, njëri prej tyre me origjinë shqiptare drejtuar Michael Granoff. Ky i fundit është kryetar i Bordit të të Besuarve, pjesë e Fondit Shqiptaro-Amerikan të Zhvillimit. Prej kohësh, atij i është përcjellë një letër nga një grup veprimtarësh, por që është firmosur nga dy aktivistë të njohur të komunitetit hebre dhe shqiptar në lidhje me një çështje që ka lidhje me procesin e transformimit të ish-Qendrës Ndërkombëtare të Kulturës (QNK) në një inkubator për novatorizmin dhe sipërmarrjen për rininë, siç është shprehur nga propaganda e shumtë. Mbase juristët do të dinë të japin përgjigje më të arsyeshme se ç'mund të bëhet në këtë rast, por duken shenjat jo të mira për mos reflektim nga ana e këtij subjekti: që nga mospërgjigja e autoriteteve të Fondit, që nuk e kanë marrë shumë parasysh letëren e drejtuar nga bashkëkombasit e tyre. Megjithatë, dy militantët e shoqërisë civile mendojnë se ka edhe instanca të tjera.

Në nder të një dite përkujtimi për profesor Eqerem Çabejn, redaktori e pa të udhës të botonte një artikull të "Jedinstvo-s", hartuar nga një publicist shqiptar, në nderim të tij, "Këtu e dyzet vjet më parë, me rastin e vdekjes së këtij njeriu të madhtë shkencës dhe, përgjithësisht të kulturës shqiptare, kam bërë një shkrim dhe se, në alfabetin cirilikë, e kam botuar në gazetën "Jedinstvo" të Prishtinës, e cila atëbotë, shquhej për shovinizëm, mos durim,

kundër shqiptarizëm të skajshëm. Se si dhe qysh ndodhi kjo, me pak fjalë, shpjegimi në vijim...", shkruan Bajram Sefaj.

Studiuesi Andon Andoni na kish sjellë një vëzhgim të ndërë për veprën e Sotir Andonit, një krijuesi modest që është lënë disi në hije, por edhe është vlerësuar hera-herës jo vetëm prej dashamirësh. "Teoria mbizotëruese nën dritën e së cilës mund të shihet tregimi i Sotir Andonit, është ajo formaliste pasi si prozë plot lëng jetësor dhe me një pasuri gjuhësore të larmishme, edhe pse kjo i shkon më përshat poezisë si forma më e lartësuar e letërsisë, tregimet e S. Andonit s'janë gjë tjetër vetëm se një prozë poetike...", shkruan ai.

Harrallamb Fandi na kish sjellë një grup përkthimesh nga autorë të njohur, porse rezultoi se në botim pati shumë gabime teknike. Redaktori, për arsye që nuk ishte në vend në momentin e fundit, lëshoi....

Pas shumë numrave të "Milosao" është kthyer një krijuese interesante, por aspak e disiplinuar. Rrëfimtaria Zhupa, do shkruante redaktori, është shumë e kursyer në mjetet e saj shprehëse, por autorja është njohëse e mirë e kanoneve të tregimit të shkurtër... Në përgjithësi mund të thuhet se ishte numër i këndshëm dhe i realizuar mirë.

Ku është ajo?

E shtypur si manaferrat.

8
ëndrrat vijnë dy llojesh:
Vertikale dhe horizontale.
Më trego formën e ëndrrës tënde
E unë do të t'them prej nga vjen ti.

13
A mundet kamera jote të kapë
Frikën në sytë
E harabeles- nënë, të shohë
Vezët e thyera brenda syve të saj?

9
Zjarri dhe drita
Djegin të dy.
Ne shkojmë të flemë tekta gjysma
tjetër
E globit zgjohet.
Dita dhe nata
Plotpërplot me ëndrra.

14
Pakëz ajër do t'thotë kaq shumë
për zogun.
Në ajër, një botë e tërë zgjerohet.
Retë mbushen a pastaj shpërhap-
en.
Gjethet përshëndesin njera-
tjetrën.
Për zogun, gjithçka varet në ajër.

10
Vështrimi yt
Më përshkon
Si rrufe.

15
Farat e shëgës
Shpërndarë nga hapat tona
Nuk ishin prej parajsës.

11
Flutura që fluturoi një çast më
parë
Mbi të vrrarët
Ishte shpirti
Që po kërkonte shtëpinë.

16
Varka ime prej letre që lundroi në
lumë
Me botën pas vetes
Kishte një shënim të veçantë.
Mund të mbërrirë një ditë,
Edhe pse vonë,
Të gjitha të vërtetat mbërrirën
vonë.

12
Koha jonë bashkë
është pjekur

17
Gjethet të thara
Atje tej
Malli ynë i parë.

18
Këpucët pas derës
Nuk do t'iu bëjnë më kur të kthe-
hen.

19
Ajo numëron guralecët pranë gish-
tave të saj.
Guralecët e tjerë nën ujë
Janë humbje që s'janë në dorën e
saj.

20
Thërrime rëre
Shpërndarë
Prej gishtave
Njerëzit tanë.

21
Dielli zbulon
Një vrimë në varkë,
Një shkëlqim në pendët
E peshqve që ende frymojnë.

22
Dita dhe nata
I ndajnë hapat tanë në rrugë
Siç ndajnë në dy gjysma
Edhe botën.

23
Unë u linda.
Unë shkruaj poezi.
Unë do të vdes.

24
Hija e saj
është ende këtu
Ushqen zogjtë.

Pllaka III

1
Si breshka,
Unë eci kudo
Me shtëpinë time mbi shpinë.

2
Pasqyra në mur
Nuk tregon asnjë prej fytyrave
Që kaluan para saj.

3
Të vdekurit
Vepronë si hëna:
E lënë tokën pas
Dhe largohen tutje.

4
Oh, milingona të vogla,
Si e cni veç para
Pa kthyer kokat pas.
Sikur të mundja të merrja borxh
hapat tuaja
Për pesë minuta.

5
Ne jemi të gjithë gjethe vjeshte
Gati për të rënë në çdo çast.

6
Merimanga ndërton një shtëpi jashtë
vetes.
E nuk e quan mërgim.

7
Të harruara
Fytyrat e të vdekurve
Sikur i takuam veç një herë
Në ca dyer rrotulluese.

8
Nuk jam pëllumb
Që ta di rrugën për në shtëpi.

9
Ashtu thjesht,
Ata i paketuan vitet tona të gjel-
bra
Të ushqenin një dele të uritur.

10
Sigurisht që s'e sheh dot fjalën
dashuri.
E shkrova në ujë.

11
Kur hëna është e plotë
Duket si zero.
Jeta është e rrumbullakët
Në fund.

12
Gjyshi u largua nga vendi vetëm
me një valixhe.
Babai mbeti duarbosh.
Biri mbeti pa duar.

13
Jo, nuk jam mërzitur me ty.
hëna, edhe ajo, vjen çdo ditë.

14
Ajo vizatoi dhimbjen e saj:
Një gur plot ngjyra
Thellë në det.
Peshqit i kalojnë përbri,
Pa mundur ta prekin.

15
Ajo ishte e sigurt
Brenda barkut të së ëmës.

16
Famarët ia dinë vlerën natës
Dhe janë më të duruar
Sesa vjet.
Ata rininë deri në mëngjes.

17
Ato lule shumëngjyrëshe
Mbi varret masive
Janë fjalët e fundit të të vdekurve.

18
Toka është kaq e thjeshtë,
Mund ta shpjegosh me një lot dhe
një qeshje.
Toka është kaq e komplikuar,

Të duhet një lot dhe një qeshje
Që ta shpjegosh.

19
Numri që sheh tani
Do të ndryshojë papra
Me hedhjen tjetër të zarit.
Jeta nuk i tregon fytyrat e saj
Të gjitha njëherësh.

20
Të dua
Njëjës
Edhe pse përdor shumësin,
Shumësin e rregullt dhe atë të par-
regullt.

21
Çasti i ëmbël mbaroi.
Harxhova një orë
Duke menduar për atë çast.

22
Flutura sjell polen,
Me këmbkat e saj të vogla, dhe flu-
turon tutje.
Lulja s'e ndjek dot pas.
Prandaj gjethet e saj dridhen
Dhe kurora i laget
Me lot.

23
Disa nga anëtarët e fisit tonë
Vdiqën në luftë.
Disa vdiqën vdekje të zakonshme.
Asnjë prej tyre nuk vdiq nga gëzi-
mi.

24
Ajo gruaja në këmbë në sheshin
publik
është e bërë prej bakri.
Nuk është për shitje.

Pllaka IV
1
Doja të shkruaja një poemë epike
për vuajtjen,
Por kur ia gjeta një tufëz flokësh
mes gërmadhave
Të shtëpisë së saj prej balte,
E gjeta atje epikën time.

2
Nuk fjeta mbrëmë.
Ishte sikur nata
Të ishte fshehur në kafënë e
mëngjesit.

3
Jeta e saj është një lojë gjarpërin-
jsh dhe shkallësh
Që i shpian pamëshirshëm prapë
tek fillimi.
Po jeta e kujt nuk është e tillë? Ajo
mbushet me frymë
Dhe hedh zarin sërish.





→ Vizion nga faqja 17

NGA DUNYA MIKHAIL*

- 4 Qyteti shndrit poshtë
Dritares së avionit, jo prej
Kockave e kafkave të shpërndara
Nën diell, por prej pamjes
Nga vrima e ngrirë e ajrosjes.
- 5 Ajo vdiq, dhe koha ndryshoi
Për ata që ajo deshi më shumë.
Por ora e saj e dorës vazhdoi tik-
takun.
- 6 Një zot mbante gjithë barrën
Derisa pesha e bindi
Ta transferonte të gjithën te nje-
riu—
Zoti i ri i përvuajtur.
- 7 Harta e Irakut duket si dorashkë,
E po ashtu duket dhe ajo e Miçi-
ganit—
Një përjasje që e bëra rastësisht.
- 8 Nëse nuk shpëton dot njerëz,
Të paktën mos i urre.
- 9 Dërdëllitja e saj më mërzit—
Nuk ia kuptoj asnjë fjalë që thotë.
Po sikur ta hedh prej akuariumit?
Po sikur ta derdh botën e saj të re
Me këtë peshkun e qelbur emi-
grant!
- 10 Dritat e panurmëta të qytetit
Që fiken e ndizen na kujtojnë
Se kemi lindur të mbërrimë,
Ashtu si kemi lindur që të ikim.
- 11 Shamitë janë të tyret,
Po lotët janë tanët.
- 12 Gra që vrapojnë zbatuar.
Pas tyre, yje bien prej qiellit.
- 13 Sa çudi,
Në ëndrën time për ne,
Edhe ti ishe një ëndërr.
- 14 Ai më tha: Ti je në sytë e mi.
Tani kur ai fle,
Qepallat e tij më mbulojnë.
- 15 Gilgameshi reshti së dëshiruari
Për pavdekësi,
Sespe veç në vdekje mund të ishte i
sigurt
Se do ta shihte mikun e tij Enkidu
përsëri.
- 16 Ca thonë se dashuri do të thotë
Ti vësh të gjitha vezët
Në një shportë.
Nëse thyhen të gjitha,
A ka mundësi të mos e gjejë gjë
shportën?
- 17 Endacakët nuk kanë frikë
Se i merr malli.
Çka kalon në sytë e tyre
është si retë që kalojnë mbi maki-
nat që nxitojnë,
Ashtu si pëllumbat humbasin ca
nga farat
Në rrugë e lëvizin tutje.
E megjithatë vetëm ata e dinë
Ç'do të thotë të kesh një shtëpi
E të ktheesh tek ajo.
- 18 Era dhe shiu nuk diskriminojnë
Tek na godasin.
Jemi të barabartë
Në sytë e stuhisë.
- 19 Kur unë isha e thyer në copëza,
Ti më bëre bashkë
Si një gëagjëzë
Copëz pas copëze.
Nuk kam më frikë
Se mos thymem
Në asnjë çast.
- 20 Duke ngrirë në male
Pa mbulesa e pa ushqim,
Dhe gjithë ç'dëgjuan ishte
Asnjë lajm është lajm i mirë.
- 21 Historitë nuk më vranë
Por do t'vdija po të mos
Jua tregoja.
- 22 Para se ti vrisnin
Ua mblohdën sendet personale
Celularët e tyre po tringëllijnë të
gjithë
Në kuti.
- 23 Ne nuk trishtohemi
Kur vdes bari. E dimë
Do kthehet prapë
Në një stinë a dy.
Të vdekurit nuk kthehen më
Por shfaqen çdo herë
Në gjelbërimin e barit.
- 24 Nëse dëshira e zjarrit na mbësh-
tjell,
Çfarë na kumton?
Që rrethi nuk ka as fillim

*Përtheu nga anglishtja
Mirela Petalli (Kapaj)

E
ESSE

PLUMBI I LIRISË

NGA REXHEP FERRI

1. Aty ku ëndrra takon të ardh-
men, ka diçka që pret për ta gjetur.
Me praninë time, humbjen time,
kjo kripë e bardhë, kripë e pastër
na ka munguar, por edhe tani po
na mungon.
Njëfarë kufiri që kursesi ta
kuptojmë.
Nuk e di si ta them ndryshe.
Në qendër të vëmendjes nuk
është më fati i njeriut.
Ata që e kanë vrarë hënën janë
mbidoza e jetës. Nuk lanë gurë mbi
gurë.
Nga lakmia e tyre të gjithëve na
ka humbur kujtesa.
Të shohim kujt t'i ndihmojmë.
Duhet të kërkojmë një shpirt-
bardhë.
Sipas besimeve, një zgjidhje.
Ajo që po sundon botën është
më shumë se një krim më shumë
se një rreshtim tronditës.
Fantazmagoria e gjeti shekul-
lin e vet.
2. Me famën e tyre, që shkeli tokën
vetëm për punët e veta është
mbushur kupa.
Po bie borë.
Digjen kujtimet.
Ju flet shpirti.
Vetëm ai e di se çka kemi hum-
bur e çka na ka mbetur.
Miqësia është bërë e mërzit-
shme.
Përpara nuk ka shpresa.
Prapa s'ka se ku të shkohet.
Njeriu i ka humbur rruga dhe
jo vetëm rruga.
Në pasqyrë i del edhe një kohë
për ta kuptuar kohën dhe një kohë
tjetër për ta harruar kohën.
Në qendër të vëmendjes nuk
është vetëm Evropa.
Është shumë e shtrenjtë për të
qenë personazh i prituri.
Drita tepër e bardhë nuk i kap
të gjitha ngjyrat.
T'i merr sytë...
- 3.

Është shumë i veçantë
ligjërimi i profesor
Ferrit dhe mënyra si
në kaleidoskop, që ai
sheh strukturën men-
dore të shqiptarit të
sotëm, por edhe
mënyrën e tij të per-
ceptimit. Fryma pesi-
miste i shkon disi
pasqyrim të vërtetë
të nënvetëdijes tonë
kombëtare...



- në dramë, mbetet shumëçka pa u
thënë.
Robëria nuk na ka mësuar as
të vlerësojmë diçka të mirë as të
harrojmë diçka të dhimbshme.
Në fushën e mejdanit nuk ka
ngjarje, ka frikë.
5. Nga heshtja as unë nuk mund
të përgjigjem.
Kur kisha ide: Historisë i erdhi
fundit!...
Evropën shpesh e shohim si
Evropë.
Nganjëherë ndoshta edhe si Af-
rikë.
-Pse mungon dielli? - gjarprin e
gurit e pyeta.
Kur jemi para kësaj sfide, si ta
kontrollojmë adrenalinen.
Me dinakërinë e natyrës së nje-
riut, mos më jepni këshilla jete.
As mos më pyesni për frikën që
e dua.
Jam i vdekur.
Njeriu që nga Zeusi e vodhi zjar-
rin, vdekjen e pa si ëndërr.
6. Për t'i harruar mëkatet e har-
ruara më kanë thënë se nuk dihet
pse ka ardhur deri te kjo pikë.
Ndoshta kemi ikur nga errë-
sira.
Nga përhumbyja zbulova fshe-
htësirën.
Nuk po e them as po e as jo.
A po mendoni se nuk e di se kur
është mjaft?
Përgjigja mbetet tek unë.
Përtej pritjeve të humbura për
ta ruajtur qetësinë, një çoban i
karashqiptarhanës.
aty ku fillon numërimi i viteve



mbrapsht shpejt bleu një diplomë se ka kryer shkollë.

Një ditë më vonë një student e pyeti:

- Profesor a e di se çka është fusnota?
- Po e di!...
- Çka është?
- Shpejt do të bëhet mirë.

7. Për një ditë, tjetër ditë, doli se nuk kemi bërë asgjë.

Kur njeriu sheh ëndrrën e vet, pse mos të themi se vetëm me një lutje biblike nuk çelet dera e parajsës.

Kënd e kemi qitur për t'i prirë karvanit, shumë mirë i kemi punët.

Kur e merr Zoti ndonjë patriot sojli, fis për fis e shtëpi për shtëpi shkon fjala: "Shyqyr Zotit që shpëtuam nga ky hajn belaxhi!"

Besoni, veç besoni. Të vërtetën nuk e sheh askush. Koha kërkon vizion të ri politik.

Këtë po e bën armiku. Pse jemi kaq zi e terr nuk po e kuptoj as unë.

Duke shkuar deri në fund, nëse ka fund, çfarë ironie!

Nuk mund të bëhemi dikush tjetër. Normalisht, dikush tjetër kot më kërkon.

Kapja për veshi prapë ka hyrë në jetën tonë.

Për të shkuar deri te mendja, me fjalë nuk kuptojmë asgjë.

8. Kam edhe diçka tjetër për të thënë:

Pse më pyetni kush jam? Po mendoni se jashtë në qytet jeta vazhdon normalisht.

Ju flas për gjyshin tim i cili mendonte se ishte unë.

Mos u shqetësoni. Herën tjetër do të besoni. Liria për gjyshin tim ishte ëndërr e bukur.

Unë nga vrima e çelësit pashë se liria qenka fjalë e bukur, ëndërr e bukur por edhe shumë e dhimbshme.

Shkurt e pakuptueshme. Na ishte njëherë një kohë, kur për herë të parë e përjetuam veten.

9. Pasioni që na ka mbajtur gjallë ka rënë në duart e liga.

Ku të shkojmë e ku ta thejme qafën.

Njerëzit gënjejnë e besojnë. Me fatin e tyre mund të bëjmë krahasime.

S'kemi ç'të fshehim. Këtë pjesë nuk e kuptojmë. Jo, thjesht, jo!

Problemi mbeti te ligjet. A kemi a s'kemi ligje, edhe kjo nuk dihet...

Tani çdo gjë e shoh bardhezi. Vetëm në shiptarhane, jeta shkon zi e terr pa e kuptuar pse.

Bukur, po jo! Për një botë si kjo nuk më besohet se jam unë.

Jeta është larguar. Ku ka ikur?

Ku mund të jetë? Ndoshta përkohësisht! Duhet të presim. Nuk ka vdekur!...

Prishtinë, 2018

A

ARGUMENT

Në Ulqinin e bukur, që përmblyet turistikisht nga shqiptarë, malazezë, kosovarë dhe serbë, tashmë s'ka më librari dhe kjo është një betejë e dytë e humbur me librin. Beteja e parë është pengesat që i bëhen librit nga zyrtarët e rajonit sa i përket infrastrukurës së botimit. Mbase për këtë duhet të flasin mesvete zyrtarët dhe jo fjalët kllishe që thonë në çdo inaugurim...



Në Ulqin nuk ka më librari

NGA BEN ANDONI

Për çdo vit, në këtë kohë, qyteti i Ulqinit organizon Panairin e Librit. Në fakt, aktiviteti

që i jep jetë kulturore këtij qyteti që prej vitit 2001, këtë vit mbajti si organizatore botuesen Irena Toçi dhe përfshiu botues nga Shqipëria, Kosova, Mali i Zi, e Maqedonia.

Qëllimi merret lehtë me mend. Në këtë periudhë të vitit qyteti shumëfishohet dhe është e lehtë që botuesit të përcjellin prodhimet e tyre por edhe të shkëmbejnë shumë gjëra mesvete. Sipas një tradite të mirë, që po krijohet dhe nga grishja natyrale turistike ofruar prej qytetit të Ulqinit, këtu mbërrijnë shumë botues të njohur, të cilët në mënyrë konstante e frekuentojnë si panairin, ashtu edhe qytetin e Ulqinit. Ndodh shpesh që në këtë aktivitet mbërrijnë autoritetet më të larta të Malit

të Zi, Shqipërisë, Kosovës të fushës së kulturës dhe jo vetëm.

Megjithatë larg të gjithave dhe përpjekjeve që bën kjo strukturë e panairit dhe fjalët e mira për ta, një shqetësim i madh qëndron në komunitetin kulturor të qytetit. Ulqini nuk ka më librari! Ajo e fundit që drejtohej nga Gazmend Çitaku, një veprimtar i mirë i shqipërisë, përkthyes dhe krijues nuk mundi të mbijetonte ngarkesës së peshës së madhe të biznesit. "E ka mbajtur me të gjitha mundimet dhe me sakrificat të panumërta", të kujton Jovan Nikoiladis, shkrimtar malazias, përkthyes dhe në shqip. Por, dashamirësia dhe përpjekja e këtij njeriu nuk ka mjaftuar sepse megjithëse për Ulqinin bëhet shumë në çdo gusht, kultura e edukimit me librin është një handicap i madh, që lidhet me pushtetin lokal dhe atë qendror. Libri, megjithë fjalët e mira të zyrtarëve shqiptarë dhe malazias, po humb publikun, që nuk

lexon më dhe që derën e librarisë e ka shumë të largët. Nuk mund ta përgjithësojmë këtë me rastin e Malit të Zi, sepse në qytete të tjera gjithsesi ekzistojnë librari, porse mund të bëjmë paralele me Shqipërinë. Kujtojmë se Durrësi, një nga qytetet kryesore në vend nuk ka librari, ashtu si edhe Korça, kurse libraritë e vogla të lagjeve pothuajse e kanë humbur gasjen me publikun. Njerëzit e kanë braktisur librin, ashtu si po zbrazin për ditë dhe kulturën për t'u turrur vetëm dukjes dhe pushtetit të rrjetëve sociale. Megjithatë, në Ulqinin e bukur, që përmblyet turistikisht nga shqiptarë, malazezë, kosovarë dhe serbë, tashmë s'ka më librari dhe kjo është një betejë e dytë e humbur me librin. Beteja e parë është pengesat që i bëhen librit nga zyrtarët e rajonit sa i përket infrastrukurës së botimit. Mbase për këtë duhet të flasin mesvete zyrtarët dhe jo fjalët kllishe që thonë në çdo inaugurim.

I IDE

NGA STAFF MILASO*

Qyteti i Poliçanit ndodhet rreth 25 km larg Beratit dhe po aq nga qyteti i Çorodës dhe kanioneve të famshme të Skraparit. Shtrihet nën këmbët e malit Tomor në shpatin e tij perëndimor. Bashkia e Poliçanit është një nga pesë bashkitë e qarkut Berat ndër 61 bashkitë e Shqipërisë. Reforma Administrativë-Territoriale e vitit 2014 i krijoi mundësinë e zgjerimit edhe me dy ish komuna të rrethit Berat, atë të Vërtoptit dhe të Tërpanit duke i dhënë një shtrirje të madhe geografike në jug, deri në kufi me bashkinë e Memaliajt dhe pothuajse gjithë anën perëndimore të malit Tomor. Me 8 mijë banorët e qytetit dhe rreth 18 mijë banorët e bashkisë është një ndër bashkitë e vogla në vend. Jetesa në qytet përballohet nga puna në industrinë e nxjerrjes dhe përpunimit të pllakave të gurit në malin e Tomorit dhe në ato pak njësi ekonomike të mbetura nga ish sistemi komunist. Ish kombinati ushtarak dikur krenaria e industrisë ushtarake shqiptare ka mbetur një territor i madh i rrethuar që fle gjumë dhe pret të zgjohet nga ndërhyrja e Ministrisë së Mbrojtjes, duke i lënë ish punonjësit e tij gjithmonë në pritshmëri. Në zonat rurale fermerët merren me ngastrat e tyre të vogla të copëzuara dhe me blegtori. Godina e bashkisë e vendosur në qendër të qytetit, e cila është rikonstruktuar dhe rregulluar mbetet ambjenti më i vizitueshëm nga qytetarët pasi aty marrin të gjitha shërbimet publike që ofron pushteti vendor. Qytetarët e Poliçanit janë më të kënaqurit në rang vendi me shërbimet që marrin prej bashkive të tyre së bashku me Korçën dhe Vorën. Indeksi i kënaqësisë qytetarë u mat nga një anketim që aktivizoi PNUD nëpërmjet projektit STAR në kuadër të matjes së efikasitetit të tyre të reja të pushtetit vendor që dolën pas reformës territoriale. Por shtrirja e madhe geografike, distanca e fshatrave nga qendra e bashkisë, numri i vogël i këshilltarëve bashkiakë, indiferenca e qytetarëve ndaj punës dhe veprimtarisë të pushtetit vendor e kanë larguar pushtetin nga qytetari. Pikërisht me synimin për të nxitur reagimin qytetar, sidomos të qytetarit të harruar në zonat periferike, dhe për të krijuar kulturën e reagimit komunitar në funksion të standardeve më të larta të demokracisë, të transparencës dhe të llogaridhënies, një numër aktorësh ndërkombëtarë janë investuar vitet e fundit në Shqipëri me donacione e mbështetje për qytetarë, grupe komunitare, media e shoqëri civile.

Këtë boshllëk po mundohet ta plotësojë LevizAlbania i cili është një projekt që synon të forcojë demokracinë vendore në Shqipëri përmes angazhimit të aktorëve të shoqërisë civile dhe individëve si kampionë të demokracisë për një qeverisje vendore cilësore.

Reagimi komunitar të shumë për të dëshiruar sidomos kur është puna për kulturën në funksion të standardeve më të larta të demokracisë, të transparencës dhe të llogaridhënies. Kjo është arsyeja që një projekt i "LevizAlbania" synon të forcojë me një lloj ideje ndryshe demokracinë vendore në Shqipëri përmes angazhimit të aktorëve të shoqërisë civile dhe individëve si kampionë të demokracisë për një qeverisje vendore cilësore...



Bashkia Poliçan, me një Komision të Qytetarëve

Projekti LevizAlbania financohet nga Zyra Zvicerane për Zhvillim dhe Bashkëpunim dhe zbatohet nga konsorciumi i tre organizatave shqiptare të suksesshme, "Fondacioni Shoqëria e Hapur për Shqipërinë", "Partnerët Shqipëri për Ndryshim dhe Zhvillim" dhe "Co-Plan".

LevizAlbania mbështet demokracinë vendore në të gjithë vendin nëpërmjet kultivimit të një shoqërie civile me bazë në komunitet, që ka ndikim dhe nxit kërkesën për qeverisje vendore cilësore nëpërmjet: Vendimmarrjes gjithëpërfshirëse; Mbikëqyrjes së qeverisjes vendore; Transparencës; Përgjegjshmërisë; Llogaridhënies; Monitorimit të ofrimit të shërbimeve publike.

Nëpërmjet organizatës "Misionarë të të Drejtave Sociale" me qendër në Kuçovë, LevizAlbania ka financuar projektin "Ngritja dhe funksionimi i Komisionit Qytetar në bashkinë e Poliçanit. Qëllimet

kyresore të këtij projekti janë: Rritja e transparencës së pushtetit vendor; Stimulimi i qeverisjes së mirë dhe transparencës; Rritja e ndërgjegjësimit të publikut për rëndësinë e transparencës dhe pjesëmarrjes në vendimmarrje. Si i tillë, projekti tenton të sjellë një traditë në monitorimin dhe rritjen e ndërgjegjësimit të pushtetit vendor në bashkinë e Poliçanit përbri luftës ndaj korrupsionit dhe për një qeverisje më të mirë dhe shërbime publike sa më afër qytetarit, veçanërisht në zonat periferike të qytetit dhe zonat rurale.

Duke patur në fokus qytetarin dhe shërbimet që i ofrohen atij, ky projekt po tenton të arrijë një sjellje më transparente të organeve vendore në ofrimin e shërbimit ndaj publikut, dhe rritjen e ndërgjegjësimit të këtij të fundit për mbrojtjen e të drejtave të tij dhe pjesëmarrjes në vendimmarrje. Projekti synon të krijojë një infras-

strukturë të qëndrueshme informimi për qytetarët. Si i tillë, do të këtë në vëmendje të tij zhvillimin e një tradite vlerësimi dhe stimulimi të kujtdo që kontribuon për transparencën e administratës publike përballë qytetarit dhe qeverisjes së mirë.

Organizata Misionarë të të Drejtave Sociale Kuçovë në këtë projekt synon të shpjegojë një metodologji me vazhdimësi në këtë sferë të luftës ndaj korrupsionit, pasi ka aplikuar projekte të ngjashme edhe në bashki të tjera në vend. Ekspertët për çështjet vendore të kësaj organizate Artur Kurti, Shpëtim Nishani dhe Ymer Hoxha në takimet e shumta që kanë organizuar me të gjitha grupet e interesit kanë bërë të mundur përcjelljen e mesazheve pozitive të qytetarit e Poliçanit. Angazhimi qytetar nënkuptohet si një pjesëmarrje aktive në jetën e qytetarëve dhe në kontributin e tyre. Niveli i besimit në pushtetin lokal përbën një faktor kryesor që përcakton masën dhe cilësinë e angazhimit qytetar.

Besimi në organet publike ndikohet nga dy faktorë: nga cilësia e shërbimit që marrin individët dhe familjet e tyre, dhe nga fakti se sa transparente e të ndershme janë autoritetet në lidhje me performancën e tyre, duke përfshirë gadishmërinë e tyre për të pranuar dhe për të mësuar rreth gabimeve të tyre. Transparencë nuk ndihmon vetëm në informimin e publikut në lidhje me zhvillimin e ideve dhe propozimeve, por edhe për të bindur qytetarët se pushtetet vendore janë të interesuara në dëgjimin e pikëpamjeve të tyre dhe përgjigjen e prioritetëve të qytetarëve. Kjo nga ana tjetër rrit legjitimitetin e procesit të vendimmarrjes dhe forcon "demokracinë e

drejtpërdrejtë".

Transparencë gjithashtu ndikon në angazhimin qytetar në mënyrë të drejtpërdrejtë. Pushtetet vendore duhet të ndajnë vlerësimet dhe planet e tyre me qytetarët si edhe të kërkojnë pikëpamjet e tyre mbi baza të rregullta të cilat mund të jenë shumë efektive në zbatimin e programeve të zhvillimit si edhe me pjesëmarrjen e palëve të interesuara. Kryetari i Bashkisë Adriatik Zotkaj, i cili është në mandatin e katërt që drejton bashkinë Poliçan e ka mirëpritur këtë projekt dhe ka mbështetur zbatimin e tij, pasi siç theksoi edhe në konferencën e hapjes për ngjashmërinë e problematikave që ka pushteti vendor në Poliçan dhe në Kuçovë si dy bashki që kanë pasur industrinë degë kryesore të ekonomisë dhe të punësimit dhe besoj që shkëmbimi i eksperiencës më të mirë do të shërbejë për përmirësimin e punëve tona në të ardhmen. Nga takimet dhe konsultimet e shumta me qytetarët janë përgjegdhur 25 përfaqësues nga të gjitha grupet e interesit ku 40 përqind e përbëjnë gratë dhe vajzat, të cilët do të përfaqësojnë mendimin qytetar në marrëdhënie me këshillin bashkiak dhe administratën e bashkisë.

Për ta institucionalizuar këtë komision është gjykuar firmosja e një memorandumit bashkëpunimi ndërmjet bashkisë, këshillit bashkiak dhe komisionit qytetar të bashkisë Poliçan.

Le të jetë ky organizëm vullnetar qytetarësh në Poliçan një ogur i mirë i reagimit qytetar jo vetëm në Poliçan por në gjithë Shqipërinë, që siç e përcaktuar edhe Tokvil "Në demokraci ndryshimet e mëdha mund të vijnë edhe nga qytetarët e thjeshtë por me parime dhe kurajë të madhe".



Dje në "Deutsche Welle"

Partnerë të vështirë, Gjermania dhe Turqia

Nga Kersten Knipp

(vijon nga faqja 1)

... përkundër ngarkesave të fundit në raportet politike, nuk ka shënuar ndonjë rënie. Shteti gjerman edhe më tej jep të ashtuquajturat garanci 'Hermes' për bizneset gjermane në Turqi. Qeveria gjermane e ka ashpërsuar politikën e saj ndaj Turqisë vitin e kaluar, pas arrestimit të disa shtetasve gjermanë. Ndaj e ka reduktuar mbrojtjen e riskut të biznesit të firmave gjermane në Turqi në një vlerë prej 1.5 miliardë euro. Ky lajm është kritikuar në Gjermani. "Nuk është e pranueshme që partneriteti mes qeverisë turke dhe asaj gjermane të zhvillohet, pavarësisht gjendjes së të drejtave të njeriut dhe rreziqeve të taksapaguesve", thuhet në një kumtesë të partisë E.Majta.

KONFLIKTET DHE MOSMARRËVESHJET

Grindjet rreth parave tregojnë se sa jounike është politika gjermane në raportet ndaj Turqisë. Ka shumë konflikte, si për shembull mbajtja nën masa arresti e shumë shtetasve gjermanë, me origjinë kryesisht turke; mosmarrëveshjet për vizitën e presidentit Erdogan në Gjermani në shtator të këtij viti; grindjet gjermano-turke për bazën e NATO-s në Incirlik, prej nga janë tërhequr ushtarët gjermanë në shtator të vitit të kaluar, apo edhe ndalimi i paraqitjes së politikanëve turq gjatë fushatës zgjedhore...

Të gjitha këto kanë ndikuar që raportet mes Turqisë dhe Gjermanisë të bien në pikën më të ulët në disa dekadat e fundit. Kësaj i shtohen edhe mosmarrëveshjet rreth fotografive të futbollistëve Özil dhe Gündogan me presidentin Erdogan. Mosmarrëveshjet dhe grindjet më të mëdha kanë ndodhur pas përcaktimit të Erdoganit dhe zhvillimeve që e kanë pasur këtë ngjarje, kur janë suspenduar apo arrestuar rreth 110.000 nëpunës, ushtarë, policë dhe gjykatës.

BOTËKUPITIME TË NDRYSHME

Raportet mes Gjermanisë dhe Turqisë janë aktualisht vërtet të këqija, thotë ekonomisti Yunus



© picture-alliance/dpa/C.

Ulusoy, nga Qendra e Studimeve për Turqinë dhe Integritet. Por shumë gjëra kanë të bëjnë me botëkuptimet e ndryshme, sepse në Gjermani më së shumti u kushtohet vëmendje mangësive në Turqi, ndërsa shtetasit turq që e mbështesin Erdoganin shohin vetëm anën tjetër. Ulusoy mendon se Gjermania dhe shtetasit gjermanë kanë të drejtë kur flasin për mangësitë në shtetin juridik dhe demokraci. Por shpesh mungon toni i duhur për të shprehur këto kritika dhe në këtë mënyrë humbet shansi për influencimin e gjërave. Tonet janë ashpërsuar vitet e fundit nga të dyja palët. Pas arrestimit vitin e kaluar të aktivistit Peter Steudtner, gazeta turke islamike "Yeni Akit" shkruante se

"Merkel është edhe më e keqe se Hitleri". Në shtator edhe presidenti Erdogan e ka sulmuar ashpër kancelaren Merkel dhe kandidatit e socialdemokratëve për kancelar Martin Schulz, të cilët u shprehën kundër anëtarësimit të Turqisë në BE. "Ajo që po ndodh është nazizëm, është fashizëm", tha Erdogan. Më parë Erdogan u kishte bërë thirrje shtetasve gjermanë me origjinë turke që të "bëjnë jo tre, por pesë fëmijë", që në Gjermani është komentuar si ftesë për mungesë luajaliteti ndaj shtetit. Ai u ka sugjeruar zgjedhësve me origjinë turke që të mos votojnë parti të e këtyre dy politikanëve në zgjedhje.

KRIKAT NGA GJERMANIA

Përgjatë gjithë kohës së grind-

jeve ka pasur kritika të ashpër edhe nga politikanët gjermanë. Kritikë më të ashpër kanë ardhur nga krahu i djathtë politik. Nga partia djathtë Alternativa për Gjermani, AfD, ka pasur edhe sharje dhe ofendime të rënda. Por edhe krerët e qeverisë janë shprehur me tone shumë kritike ndaj Erdoganit dhe mundësisë së paraqitjes së tij në fushatë elektorale në Gjermani. Paraqitja e tij para votuesve me origjinë turke në Gjermani është kundërshtuar nga radhët e pothuajse të gjitha partive.

INTERESAT E PËRBASHKËTA

Përkundër tensioneve dhe grindjeve, Gjermania dhe Turqia kanë edhe më tej lidhje të mëdha

ekonomike dhe interesa të përbashkëta. Por jo vetëm në ekonomi, sepse Gjermania dhe Turqia janë të interesuara edhe për përfundimin e luftës në Siri, për shkak se në këto vende kanë ardhur jashtëzakonisht shumë refugjatë sirianë. Ato shprejnë se me përfundimin e luftës mund të krijohen kushtet për largimin e sirianëve dhe kthimin në vendlindje. Ka shumë gjëra pra, për të cilat duhet të bisedojnë Ankaraja dhe Berlina, thotë Yunus Ulusoy. "Vizita e Erdoganit në shtator në Gjermani është një mundësi për shtimin e influencës gjermane në politikën turke, në veçanti pas tensioneve diplomatike mes Turqisë dhe SHBA".

BalkanWebj.com

AGJENCIA E LAJMEVE MË E KLIKUAR NË HAPËSIRËN SHQIPTARE. LAJMET MË TË FUNDIT ME VIDEO DHE FOTO NGA VENDGJARJA, ANALIZA DHE TEMATIKA TË NDRYSHME, GJITHÇKA ME NJË KLIKIM.



INSTALONI APLIKACIONIN E BALKANWEB NË MOBILE DHE TABLET

KERKONI NE APPLE STORE DHE GOOGLE PLAY OSE DUKE SKANUAR QR CODE APPLE DHE ANDROID

MERRNI NE KOHE REALE LAJMET E FUNDIT NE APARATIN TUAJ



Opinion i Ditës

Lista e veteranëve, krimi i përsosur i radhës

Ng Arben Idrizi

(vijon nga faqja 1)

... kosovare. Kush më shumë e kush më pak, i përfshirë në pothuajse të gjitha krimet

Largimi i Prokurorit Special, Elez Blakajt nga posti i tij me arsyetimin se është ndier i kërcënues në punën e tij, u përcoll me habi, por edhe me ndonjë akuzë që kërkonte t'i zhvlerësonte qëndrimet e tij.

Cilido që të jetë motivi i vërtetë i dorëheqjes, ai ka lënë pas vetes një dosje të tërë të hetimit që i ka bërë përkritazi me çështjen namkeqe të njohur si fryrja e listave të veteranëve të luftës. Nga hetimi, i pakundërshtuar nga askush si i tillë, të paktën deri më tani ka dalë se fryrja ka ndodhur dhe praktikisht është bërë nga dhe me bekimin e disa prej figurave më të njohura të UÇK-së si dhe të krerëve të tanishëm të shoqatave të dala nga lufta. E në të vërtetë, për fryrjen kanë qenë në dijeni edhe të gjitha personalitetet e tjera politike, në krye të shtetit. Përveç ndonjë akuzë të rrallë nga ndonjë deputet, që për më tepër tërë atë e bënte në vulltin e ndonjë inati politik, askush nuk ka bërë asgjë që fryrja të mos realizohet.

Për ta kryer këtë krim, ata kanë injoruar të gjitha paralajmërimet e FMN-së. Së fundmi, për ta mundësuar pagesën e rrogave sipas listave të fryrja të veteranëve është plaçkitur edhe ai fond i mjerë i mezi grumbulluar i sigurimeve shëndetësore, i cili për këtë shkak nuk do të mund të funksionalizohet edhe disa vite.

Së fundmi, për ta bërë gjoja më të besueshëm mashtrimin, zyrtarët e verifikimit të listave – ndër të cilët spikat emri i gjeneralit Agim Çeku – kanë shkruar deri aty sa e kanë sajuar një brigadë të tërë, të quajtur "Hasan Prishtina".

Duke lexuar procesverbalet dhe dokumente të tjera, të hulumtuara nga prokurori, vërehet fare qartë se në të vërtetë autorët e krimit as që e kanë problem mashtrimin e hapur. Shqetësimi i tyre i vetëm, fare i vockël, është se mbase mund të ketë ndonjë pyetje të pakëndshme në opinion, për rrjedhojë duhet t'i kenë fillan përgjigjet e gatshme.

Në dukje është një skenar i thjeshtë banditësh të rrugës, të veshur me uniforma zyrtare. Mund të duket i padëmshëm dhe shpejt i zbërthyeshëm, por në të vërtetë është krimi i thjeshtë, i përsosur i një bande në krye të shtetit. Mashtrimi nuk është bërë nga një grup i izoluar, por nga një grup i mbikëqyrur dhe raportues të një autoriteti i lartë, nga i cili ka marrë bekimin për cilindo keqpërdorim në interes të për-



bashkët të bandës. Krimin e kanë bërë të mundshëm të gjithë ish-komandantët dhe eprorët e tjerë të UÇK-së. Tre prej tyre janë zyrtarët kryesorë të shtetit sot: Hashim Thaçi, Ramush Haradinaj dhe Kadri Veseli.

Cilido që të jetë motivi i vërtetë i dorëheqjes, ai ka lënë pas vetes një dosje të tërë të hetimit që i ka bërë përkritazi me çështjen namkeqe të njohur si fryrja e listave të veteranëve të luftës. Nga hetimi, i pakundërshtuar nga askush si i tillë, të paktën deri më tani ka dalë se fryrja ka ndodhur dhe praktikisht është bërë nga dhe me bekimin e disa prej figurave më të njohura të UÇK-së si dhe të krerëve të tanishëm të shoqatave të dala nga lufta.

Meqë të gjithë e dinë, tingëllon bukur banale të thuhet se ai që është i përfshirë në një krim nuk do ta gjykonte kurrë veten për të tillë. Do të gjejnë, siç kanë gjetur deri më tani, marifete për ta heshur të tërën.

Kuptohet, fryrja e listave të veteranëve është vetëm një krim më shumë në listën e përgjithshme të krimeve të kryera që nga lufta nga klasa politike kosovare. Kush më shumë e kush më pak, i përfshirë në pothuajse të gjitha krimet.

"Gazeta Express"

HOROSKOPI

DASHI

Vetëm sepse jeni i trishtuar në këtë moment, nuk do të thotë që duhet të jeni i stresuar edhe nesër. Ekzistojnë mënyra për ta larguar mërzitjen thjesht duke mbyllur sytë dhe u qetësuar.

DEMI

Sot është një prej atyre ditëve ku përpjekjet për të sqaruar një çështje të caktuar mund ta shtojnë më shumë konfuzionin. Megjithatë, nuk do t'ju mungojë dashuria e të tjerëve.

BINJAKET

Lëreni pas të vjetrën dhe mësohuni me të renë. Ky duhet të jetë qëndrimi juaj për sot. Energjia dhe motivimi janë në nivel të lartë sot, por në rrugë e sipër mund të ndodhin edhe gabime të vogla.

GAFORJA

Sot kenë një tendencë për t'u nxituar në gjithçka që bëni apo në projektet tuaja. Partneri juaj në këtë moment ndihet i lënë mënjanë. Do ishte mirë t'i lini pak pas dore këto projekte.

LUANI

Pritet të jetë një ditë e bukur me aktivitete shoqërore. Nuk do të mungojnë surprizat veçanërisht nga ana e partnerit tuaj. Shijoni çdo moment të ditës suaj.

VIRGJERESHA

Sot ka të ngjarë të merrni disa lajme të mira. Mos e mendoni dy herë dhe mos u shqetësoni për asgjë. Pranojeni ashtu siç është, sepse mund të jetë diçka pozitive.

PESHORJA

Meritoni të pushoni sot. Largo-huni nga angazhimet dhe detyrat dhe fokusohuni te vetja juaj, duke shijuar në maksimum ditën. Relaksimi do të sillte benefite të në jetën tuaj.

AKREPI

Sot ju pret një ditë e kënaqshme dhe intensive njëkohësisht. Kurioziteti është në nivelin më të lartë dhe sot kombinohet me imagjinatën tuaj të gjallë. Mund ta shihni botën me një perspektive krejt tjetër.

SHIGJETARI

Dita e sotme është e mirë për krijimin e marrëdhënieve. Edhe nëse ato janë personale apo profesionale, prisni të ndodhin gjëra mira në jetën tuaj. Rrezatoni dashuri.

BRICJAPI

Është koha që të zgjeroni horizontin. Jeni rritur mjaftueshëm për të kuptuar se nëse do të ndodhë një ndryshim në jetën tuaj, atë duhet ta bëni vetë ju.


UJORI

Edhe pse kërkoni të ndryshoni situatën tuaj financiare, mos veproni me nxitim. Nëse ka shumë zgjedhje, zgjidhni më të mirën pasi të jeni menduar.

PESHQIT

Ka të ngjarë të keni punuar shumë për një kohë të gjatë. A nuk mendoni se ka ardhur koha të bëni pak pushim? Ndoshta duhet të largoheni për pak kohë nga qyteti.

Fjalëkryqi (1)



HORIZONTAL

1. Ishte dekret i sulltanit.
8. Fillojnë nazet.
9. Eshhtë bosht.
10. Eshhtë studio e Barack Obama-s.
13. Fillojnë romanin.
14. Pak nepozitëm.
17. Mbahen për të ndaluar.
18. Janë njerëz me dy faqe.
21. U mbiqajti Princi i oratorëve.
22. Nofka e Eisenhoëer.
24. Janë ministri.
25. Pak normalitet.
26. Rodrigues, që u quajt mbretëresha e fado-s.
27. Kush është... nuk është i lirë.
29. Bën be pa u betuar një e tillë.
30. Kështu mbyllet dera.
33. Eshhtë për medaljen e parë
34. Janë nofka.

38. Sateliti i Jupiterit.
39. Fillojnë matjet.
41. Në krye tëv idealisatëve.
42. Një Ibrahim violinist.
44. Ekstre me sirtar.
45. Kështu shtë lojtari i under 21.
47. Eshhtë gjuajtja personale.
49. Mund të ushtrohet edhe psikologjik
50. Gëlonin nga gladiatorët.

VERTIKAL

1. Eli këngëtare.
2. Pak ekologjike.
3. Rastis në kufij.
4. Janë temperuraturat më të ulëta.
5. Inicialet e Lendi.
6. Jetojnë në kryeqendrën piemonteze.
7. Campion regjisore.
8. Gabim rrjete në tenis.
11. Janë si cilësi.
12. Ishte gjuha e romakëve.
15. Flet për bëmat e kreshnikëve.
16. Janë shërbimet me... korrespondencë.
17. I vihat kalit.
18. Rrapo i luftëtarëve.
19. Aktet pa kufij.
20. Mbyllet me dorezë.
21. Eshhtë periudha e ftohtë.
23. Në krye të komandës.
24. Një artist si Tristan Tzara.
28. Janë sportistët që bëjnë stil të lirë.
31. Hapin pa kufij.
32. Qethen me qen.
35. Një mendim.
36. Kusturica, regjisor.
37. Parajsja e humbur.
39. Një stacion i famshëm orbital.
40. Pak aromatike.
43. Pak interesante.
46. Lirë në qendër.
48. Nota e diapazonit.

Fjalëkryqi (2)

HORIZONTAL


1. Bunuel regjisor.
4. Të parat në sport.
6. Rodrigues që këndonte fado.
11. I famshmi Pacino.
12. Kujdeset në... ekstreme.
14. Eshhtë skllavëri.
16. Eshhtë shtypja jo përditshëm.
18. Janë tek në banka.
20. Eshhtë ndeshje e... fundit.
21. Lumi i Bernës.
23. Janë me numër ato ushtarake.
24. Nesti pa pa çifte.
25. Si gjithë.
26. Sipërfaqe e shkurtër.
27. Ato të peshkut janë pa vlerë
28. Janë marifete... me grim.
31. Eshhtë e tij zonë kërkuesit.
32. Skuadra merengue.

HORIZONTAL


33. Eshhtë trofet që fitohet.
34. Ndahen nga ortakët.
36. Një biçikletë dyshe.
39. Qetësonte detin.
42. Kanë dhoma që zihen.
44. Eshhtë ekulibri në palestër.
46. Në krye të jurisë.
47. Numri i kuartetit.
48. Gjysmë armate.

VERTIKAL

1. Gjysma e lapsit.
2. Përfundojnë pingul
3. Shkruhen për filma.
5. Duhet realizuar.
6. Gabim pa kufij.
7. Portokalli i Stanley Kubrick.
8. Në krye të artistëve.
9. Eshhtë edhe ai i rekordeve.
10. Fleming që krijoi James Bond.
13. Janë binarë.
15. Janë dhoma.
16. Eshhtë i zi... pikant.
17. Institucione Lokale Tiranë.
19. Pagëzoi Shën Palin.
20. Eshhtë besimi i besimtarëve.
22. Janë pamje nga puna.
26. Janë aksione për... gol.
27. Një fjalë për më vonë.
29. Maria Rilke, shkrimtar.
30. Fillojnë turnin.
32. Kupa e fituar gjithmonë nga Brazili.
34. Eshhtë copë... torte.
35. Mbyllin një tender.
34. Ndo në kufij.
38. Një pëlhurë.
40. Lidh dy brigjet.
41. Një pije piratësh.
43. Fillojnë lehtë.
45. Të fundit në sirtar.



Gjeni ndryshimin



Dy figurat kanë ndryshime nga njëra-tjetra



Përgjigja, ja cilat janë ndryshimet e figurave

SUDOKU

	4			9					
	7			1	8	9			
	9				6	1			
							3		
5	2	6	8						4
			4	6				5	8
3				4					2
	6								
1			2	5					

Plotësoni vendet bosh në mënyrë që çdo kolonë të ketë numrat nga 1-9

Përgjigje e sudokut të numrit të kaluar

5	3	1	8	4	6	9	2	7
2	4	7	9	3	1	6	5	8
6	9	8	7	2	5	1	3	4
1	8	4	6	5	2	7	9	3
7	2	3	1	8	9	4	6	5
9	5	6	3	7	4	2	8	1
8	7	9	2	1	3	5	4	6
3	6	5	4	9	7	8	1	2
4	1	2	5	6	8	3	7	9



Argëtim filozofik

- Teori është kur njeriu din gjithçka dhe asgjë nuk funksionon. -Praktikë është kur gjithçka funksionon, por askush nuk e di përse. Tek ne teoria dhe praktika janë të bashkuara: asgjë nuk funksionon dhe askush nuk e di përse.
- Karriera e një piktori është si karriera e një prostitute: në fillim e bën atë për kënaqësinë e tij, pastaj për kënaqësinë e të tjerëve, dhe në fund, për të para

KRIPTOSKEME

KRIPTOSKEME

Përgjigja e numrit të djeshëm



Thënie të mënçura

- - Bota është një skenë, ku ndarja e roleve është shumë e gabuar.
- -Për gran unë jam një e keqe e domosdoshme dhe gruaja për mua është një e mirë padobishme.
- -Emigranti lind në një vend, mplantet në një vend të tjetër dhe kur del në pension është i huaj për të dy vendet.
- -Nuk besoj se mund të bëhesh i lumtur duke bërë të tjerët fatkeq.

